



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:057911

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06265924

**PAKR.nr.422/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Njomza Svarça, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve, Sh.G., nga Deçani, për shkak të veprave penale, vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, dhe I.C., nga Deçani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, dhe të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.50/2023, të dt.16.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 03.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I.Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.50/2023, të dt.16.05.2024, lidhur me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, të përshkruar më për së afërmi sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, përkitazi me vendimin për dënimin me burgim, ashtu që kolegji penal i Gjykatës së Apelit, të akuzuarit Sh.G., i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.

Të akuzuarit Sh.G., në kuptim të nenit 80 par.1 lidhur me par.2 pika 2.1 dhe 2.2 i shqiptohet dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Dënimi i shqiptuar me burgim është në ekzekutim e sipër.

Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit Sh.G., i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.23.09.2018, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim, por jo më gjatë sesa dënimi i shqiptuar.

I akuzuari ngel në paraburgim deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.50/2023, të dt.16.05.2024, janë shpallur fajtor të akuzuarit, Sh.G., për veprat penale, vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe I.C., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe u janë shqiptuar dënimet,

-Të akuzuarit Sh.G.,

-për veprën penale të përshkruar sikurse nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve,

-për veprën penale të përshkruar sikurse nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve.

Në kuptim të nenit 80 te KPK, të akuzuarit Sh.G., i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 23.09.2018, gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar, por jo më gjatë se i njëjti i shqiptuar.

Është obliguar i akuzuari Sh.G., që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 500 (pesëqind) Euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit i është vazhduar masa e paraburgimit.

- Të akuzuarit I.C., për vepër penale sikurse nën pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë) Euro, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë, nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj në afatin e paraparë ligjor, atëherë i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar me burgim nga 20 (njëzet) Euro.

Është obliguar i akuzuari I.C., që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 300 (treqind) Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 (dyqind) Euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Janë konfiskuar armët “Beretta model 92 FS”, kalibër 9mm, me numër serik Ber. 706093, një karikator të të njëjtës armë dhe 11 fishekë si dhe pistoleta e tipit “Blow 92” e kalibrit 9mm, më numër 15-13061191, një karikator dhe një fishekë. Të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të shkatërrohen, të cilat gjenden në ruajtje sipas rastit policor 2018DC-338.

Të dëmtuarit I.T., N.T., edhe A.C. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet po të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuari Sh.G., të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK dhe ti shqiptohet dënim më i ashpër, kurse për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, të akuzuarit Sh.G., dhe të akuzuarit I.C., tu shqiptohen dënime me burgim më të ashpra.

-ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av.Berat Tmava, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet, i akuzuari të shpallet fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, si dhe të akuzuarit I.C., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, tu shqiptohen dënime më të ashpra.

-po ashtu ankesë ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të akuzuarit Sh.G., ti shqiptohet dënim më i ulët.

-përgjigje në ankesë të prokurorisë si dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, ka ushtruar av.Besnik Berisha, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore

në Gjilan, si dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, të refuzohen si të pabazuara.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.386/2024, të datës 18.07.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.50/2023, të dt.16.05.2024, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet po të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, ose që i aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit Sh.G., ti shqiptohen dënime më të ashpra, sikurse të akuzuarit I.C..

Po ashtu të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava.

Të refuzohet ankesa si dhe përgjigja në ankesë e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, si të pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.03.10.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari Sh.G., së bashku me mbrojtësin e tij, av.Besnik Berisha, i akuzuari I.C., përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, të dëmtuarit N.T. dhe I.T., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, e dëmtuara A.C., dhe mbrojtësi i të akuzuarit I.C., av.Veton Berisha, përkundër asaj që janë njoftuar me rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, ka deklaruar se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar, duke apeluar që kjo çështje penale të merr zgjidhje sa më të drejtë, që i akuzuari të shpallet fajtor për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.5 të KPK, dhe ti shqiptohet dënimi përkatës ligjor, për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

I dëmtuari I.T., ka deklaruar dhe ka apeluar që kjo çështje penale të merr epilog sa më të drejtë dhe të shpejt, duke deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale, ndërsa nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

E dëmtuara N.T., deklaron se e mbështet në tërësi ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av.Berat Tmava.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, ka deklaruar se kjo çështje penale meriton që të merr epilog sa më të shpejtë dhe të drejtë, kurse sa i përket dënimin të shqiptuar prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj, jemi të bindur se është i ashpër dhe ka propozuar që të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të

akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i favorshëm, duke pasur parasysh rrethanat e ofruara në këtë çështje penale.

I akuzuari Sh.G., ka deklaruar se e mbështet mbrojtësin av, Besnik Berisha, dhe i kërkon falje palës së dëmtuar, për veprën e kryer penale.

I akuzuari I.C., deklaron se në këtë çështje penale nuk ka çka të deklaroj.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Bensik Berisha, për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, përkitazi me vendimin për dënimin është aprovuar, kurse sa i përket ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, për të gjitha pikat e aktgjykimit, si dhe ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, janë të pabazuara.**

Prokuroria Themelore në Gjilan, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ankimar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.1.10 dhe par.2.nën par.2.7 të KPPK sepse nga përmbajta e aktgjykimit, vetëm është bërë përshkrim i deklaratave të dëshmitarëve, rrjedhjes së çështjes lidhur me rihapjen e procedurës, si dhe fjalët përfundimtare të palëve, mirëpo askund nuk mund të vërehet që aktgjykimi i nxjerrë është arsyetuar, si dhe janë dhënë arsye se pse është nxjerrë një kështu lloj vendimi, përkundër asaj që dispozitat përkatëse ligjore kërkojnë. Qe gjykata e shkallës së parë ka vepruar gabimisht me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, hasim në vlerësimin edhe mendimin mos pajtues në faqen 3, ku është bërë përshkrimi i vendimit, duke dhënë edhe mundësinë e shikimit të votimit të anëtarëve të trupit gjykues, të cilët kanë shpreh mos pajtim lidhur me çështjen juridike dhe çështjen faktike me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, ngase shumica kanë vlerësuar që duhet të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK, mirëpo në faqen 2, qëndron konstatimi se duke u bazuar në sugjerimet paraprake të Gjykatës së Apelit, nuk është pajtueshmëria me mendimin e shumicës së trupit gjykues, ashtu që çështja ka përfunduar pa një vlerësim të tërësishëm.

Gjykata e shkallës së parë, duke mos vlerësuar aktgjykimin konform dispozitave të KPPK, i cili në mënyrë shprehimore parasheh mënyrën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe kalimin nëpër fazat e duhura, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe pastaj kalimin në seancë për këshillim e votim, e cila është e mbyllur në të cilën marrin pjesë vetëm anëtarët e trupit gjykues, si dhe procesmbajtësi, duke llogaritur që votimi është konfidencial, nuk lejohet asnjë interferim tjetër, por vetëm është kompetencë e trupit gjykues.

Po ashtu në këtë çështje penale janë bërë edhe gabime të tjera, e sidomos në faqen 5 të arsyetimit lidhur me deklaratën e dëshmitares N.M., e cila gjatë seancës së rishqyrtimit, ka theksuar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në seancën gjyqësore, duke iu shmangur deklaratave të dhëna në polici dhe prokurori, andaj për të vlerësuar saktësinë e secilës provë, gjykata është dashur të vërtetoj se cila deklaratë paraqet kredibilitet për vendosje, e më pastaj të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurë penale, të paparapara në nenin 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë është përkujdesur që aktgjykimi të jetë sa më i drejtë dhe i bazuar në ligj, duke mos u përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që ka vlerësuar aktgjykimin si tërësi dhe ka ardhur në përfundim se pikat e përshkuara në dispozitiv të aktgjykimi sa i përkasin të akuzuarit Sh.G., pika I dhe II, të akuzuarit I.C., pika III, e dispozitivit të aktgjykimit, janë në harmoni me arsyet e dhëna për secilën pikë të dispozitivit të aktgjykimit, ngase gjykata e shkallës së parë, me rastin e përpilimit të aktgjykimit, ka nxjerr aktgjykim të drejtë, ashtu që dispozitivi është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me arsyet e dhëna për çdo pikë të aktgjykimit, sepse i njëjti përmban fakte vendimtare të cilat e karakterizojnë secilën veprë penale, përkatësisht veprën penale në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, për të akuzuarin Sh.G., si dhe veprën penale të përshkruar sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, për të akuzuarin I.C..

Duke vlerësuar aktgjykimin sipas pretendimeve ankimore, kolegji vije në përfundim se i njëjti nuk përshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara në nenin 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2.2.7 të KPPK, sepse nga aktgjykimi rezulton se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, e sidomos duke akceptuar arsyetimin në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, lidhur me të akuzuarin Sh.G., ashtu që pas procedimit të gjitha provave personale, po ashtu edhe provave materiale, në mënyrë të drejtë dhe të qartë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK. Kjo rezulton ngase nga vet deklarata e të akuzuarit Sh.G., i cili e bënë përshkrimin e veprës penale të kryer, ka deklaruar se në asnjë mënyrë nuk ka pasur dashje apo qëllim që ta privon nga jeta këtu të dëmtuarin A.T., me të cilin edhe kanë punuar së bashku, mirëpo arma të cilën e ka përdorur dritën kritike, revolen e llojit “Bereta model 92, FS”, gjithnjë ka pasur bindje se e njëjta nuk ka qenë e vërtetë, por pasi që ka qenë në distancë 4-5m, ka ndërmarrë veprim të pa qëllimshëm dhe e ka goditur këtu të dëmtuarin gjithnjë duke qenë i bindur se arma ka qenë me gaz, pasi që paraprakisht ka marrur informacionin nga ana e xhaxhait të tij I.C., se arma me gaz gjendet në fiokë. Përndryshe për veprimin e ndërmarrë ka deklaruar se nuk ka pasur motiv për të privuar nga jeta të ndjerin, të cilën deklaratë e vërtetojnë edhe dëshmitë e dëshmitarëve, Z.T., L.P., Sh.T., G.B., Z.B., T.M. dhe R.M., e po ashtu edhe është vërtetuar nga ekspertiza e kryera, nga ana e ekspertëve. Në këtë çështje penale dhe të gjitha provat materiale të cilat janë proceduar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë

vlerësuar se të njëjtat kanë qenë në harmoni me provat personale, andaj gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur ka bërë rikualifikimin juridike të veprës penale nga vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, në veprën penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK.

Po ashtu nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, rezulton se aktgjykimi nuk përfshihet as me shkeljet e parapara në nenin 384 par.2 pika 2.7 të KPPK, sepse nga po e njëjta gjykatë në mënyrë të qartë dhe të bindur janë dhënë arsye lidhur me të gjitha faktet të cilat janë vërtetuar nga provat e proceduara, gjithnjë duke pasur parasysh postulatit “provat procedohen, faktet vërtetohen”, andaj nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka dhënë arsyet për çdo provë e cila është poseduar për të vërtetuar faktet të cilat e karakterizojnë veprën penale sikurse në diapozitiv të aktgjykimit.

Gjithashtu, kolegji vlerëson se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të plotë, janë vlerësuar saktësia e të gjitha provave nga shkresat e lëndës, duke pasur parasysh që gjykata e shkallës së parë, ka proceduar me të gjitha provat personale, si dhe ato materiale, për të vërtetuar faktet e ekzistimit të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK, andaj në mënyrë të drejtë dhe të qartë vije në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar ekzistimi e veprës penale për të cilin është shpallur fajtor, si dhe veprave penale të përshkruara sikurse në pikën II dhe III për të akuzuarin I.C..

Eliminimi i të gjitha kundërthënieve të cilat kanë qenë prezentë në aktgjykimin e kaluar, rezulton se janë eliminuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka vepruar në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 406 i KPPK, andaj kolegji i kësaj gjykate, vije në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Edhe sa i përket shkeljeve të ligjit penal, Prokuroria Themelore ka ushtruar ankesë, duke theksuar se në këtë çështje penale, nga të gjitha provat në shkresat e lëndës, është vërtetuar se kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, përkundër asaj që ka pasur para vetes aktakuzën e ngritur më këtë lloj të veprës penale, pasi që është vërtetuar se me dashje është privuar nga jeta këtu i dëmtuari, A.T., të rrezikuar kanë qenë edhe të pranishmit e tjerë, koleg të punës së të ndjerit, A.H. dhe F.Z., andaj është dashur ta ketë parasysh edhe këtë rrethanë dhe ta gjej figurën e veprës penale e jo i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e prokurorisë, lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, nga neni 385 i KPPK.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale ka proceduar me shumë prova nga shkesat e lëndës, sikurse janë provat personale, marrja e deklaratës së të akuzuarit, dëshmitarëve, të dëmtuarve, nga kjo çështje penale, e sidomos dëshmitarit A.H. dhe F.Z., dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet nga ankesa e prokurorisë nuk janë të bazuara, sepse gjykata e shkallës

së parë ka ardhur në përfundim pasi që ka vlerësuar të gjitha provat personale, po ashtu edhe materiale, dhe ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia.

Kjo pasi që nga vlerësimi i të gjitha provave nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se i akuzuari Sh.G., nuk ka pasur qëllim apo dashje që ta privon nga jeta, këtu tani të ndjerin, pasi që ka marrë revolen nga sirtari (fioka), dhe e ka përdorur të njëjtën, gjithnjë duke qenë i bindur se revolja ka qenë me gaz, dhe se ka qenë i bindur se nuk do të rrezikon jetën e këtu të dëmtuarit, mirëpo fatkeqësisht fisheku i cili e ka goditur këtu të dëmtuarin pasi që ka qenë distanca 4-5m, dhe atë në mollëzën e djathtë të fytyrës, ka qenë vdekjeprurës.

Pasi që gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 i KPK, ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale e vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.5 të KPK, i cili rikualifikim jemi të mendimit se është bërë drejt nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale e cila është e paraparë me ligj si vepër penale, sikurse janë të parapara edhe vepra e përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, kundër të akuzuarit Sh.G., dhe vepra penale e përshkruar sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, kundër të akuzuarit I.C., andaj drejt ka vendosur kur të njëjtit i ka shpallur fajtor, pasi që nuk ka gjetur rrethanat të cilat i përjashtojnë të akuzuarit nga ndjekja penale, si dhe nga përgjegjësia penale, dhe se ka aplikuar ligjin, i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, andaj edhe vendosja e çështjes penale, është vendosur në kuadër të kompetencës ligjore që e ka pasur gjykata e shkallës së parë, me marrjen e vendimit për shpalljen fajtor të akuzuarve si dhe vendimeve të tjera.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar, duke ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale për të cilën e ka shpallur fajtor, e jo të veprës penale, për të cilën ka qenë i akuzuar, si në aktakuzë e dt.12.06.2019, sepse i akuzuari Sh.G., ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, sepse që nga momenti i përfundimit të bisedës telefonike, zemërimit të shfaqur në fytyrën e tij, nxjerr armën nga sirtari, e ka mbushur dhe me të njëjtën shtinë në drejtim të tani të ndjerit A., veprime të cilat janë konstatuar në përshkrimin e bërë nga ana e ekspertëve të balistikë. Deri në momentin e goditjes ka pasur dashje që të godet në drejtim tashmë të ndjerit A..

Po ashtu në aktakuzën, e cila mbështetet nga të gjitha provat, janë të specifikuar edhe veprimet e marra nga i akuzuari i dytë I.C., i cili në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar armën e zjarrit, andaj këto çështje gjykata e shkallës së parë është dashur ti ketë parasysh edhe kur e ka bërë rikualifikimin e veprës penale, sepse nuk kemi të bëjmë me vepër penale sikurse është rikualifikim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse aktet të cilat janë vërtetuar, janë proceduar me prova nga shkresat e lëndës.



Gjithnjë duhet pasur parasysh që të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurë, për të vërtetuar gjendjen faktike, shkojnë në favor të të akuzuarit, mirëpo në këtë çështje penale nuk kemi të bëjmë me rikualifikim çfarë është bërë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në këtë çështje penale parimi “indubio pro reo”, nuk mund të vije në shprehje, sepse ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë ekzistimin e veprës penale të vrasjes së rëndë dhe armë mbajtjes pa leje.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, është dashur të përkujdeset që të vlerësoj në masë të duhur duke u bazuar në dispozitat ligjore, që të gjitha provat nga shkresat e lëndës, e po ashtu edhe qëndrimin e ekspertëve të balistikës, me numër të referencës AFK/2019-72, të dt.19.04.2019, nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, respektivisht eksperteve Qëndrim Topalli dhe Lutfi Raci, të cilët pasi që kanë konsultuar tërë materialin e ofruar dhe në bazë të video incizimit kanë konstatuar njohurit e të akuzuarit në përdorimin e armës, se i njëjti ka njohuri sikur edhe për përmbushjen e armëve tek veprimi i repetimit, shenjëstrimi me armë, teknikën e marrjes në shenjë, stabilizimin e armës dhe gjuajtjes me te, mënyrën e veprimet pas shkrepjes së armës së zjarri, të gjitha këto veprime të vërtetuara janë në mënyrë të pa dyshimtë për kryerjen me dashje të akuzuarit, për ta privuar nga jeta tani të dëmtuarin. Që të gjitha deklaratat e ekspertëve, Qëndrim Topalli dhe Lutfi Raci, kanë qëndruar pranë konstatimeve të bëra në ekspertizë, kurse eksperti Lutfi Raci, i cili përveç që ka theksuar se armët kanë qenë objekt i ekzaminimit, më saktësisht është provuar që arma e tipit “Bereta”, a ka qenë funksionale, ka vërtetuar se ka qenë, dhe pa defekte, andaj pas vlerësimit të të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë, është dashur që të vërtetoj të gjitha faktet për veprën penale të vrasjes sikurse në aktakuzë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë nuk janë të bazuara sepse gjykata e shkallës së parë pasi që ka proceduar nga të gjitha shkresat e lëndës, sikurse janë provat, deklaratat e të akuzuarit Sh.G., e të akuzuarit I.C., nga të cilat nuk mund të vërtetoj se i akuzuari Sh.G. me dashje ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.5 të KPK, e po ashtu edhe nga deklaratat e të dëmtuarve, A.C., dëshmitarëve Z.T., L.P., Sh.T., G.B., Z.B., T. M., R.M., si dhe të gjitha provat materiale nga shkesat e lëndës, sikurse në vijimësi:

-Flesh Raport nr.2018-DC-338, i dt.23.09.2018

Raport i policit Hysen Demalijaj i dt 23.09.2018

-Shënim zyrtar i hetuesve Xhavit Nimani dhe Hysen Mazrekaj me nr.2018-DC-338, i dt 23.09.2018.

Raport njoftues i dt. 24.09.2018, nr.2018-DC-338.i hetuesit Imer Hylaj .

Raport i policit hetues nga vendi i ngjarjes i dt. 23.09.2018, i rreshterit Riza Mahaj.

Raport policor hetues i dt. 23.09.2018, Imer Hylaj

Raport policor hetues i dt. 24.09.2018, Imer Hylaj

-Deklarata e te dyshuarit Sh.G. e dhëne ne polici me dt. 23.09.2018.

-Deklarata e dëshmitarit Z.T., e dt.23.09.2018.

„Deklarata e te dëshmitarit N.Gj., e dhënë ne polici me dt.23.09.2018  
-Deklarata e dëshmitarit A.H., me po te njëjtën date 23.09.2018 .  
-Deklarata e dëshmitares F.M., me po te njëjtën date dhëne ne polici me dt.23.09.2018  
-Vërtetim mbi konfiskime armës e Llojit Bereta me nr. 2018-DC-338 e dt.23.09.2018,  
-shikohen Foto dokumentacion i SMS-ve nga telefoni i N.M.,  
-Deklarata e dëshmitares N.M., e dhëne ne polici me dt.25.09.2018  
-Vërtetim mbi konfiskim i dt.24.09.2018 te telefonit me nr.044/998-816 i te pandehurit  
Sh.G.  
Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt.25.09.2018  
Raport i policit Imer Hylaj i dt.25.09.2018-  
-Lista e dëshmime e dt.23.09.2018 me nr.2018-DC-338 i 2 telefonave te Llojit ‚IPHONE‘  
i te pandehurit Sh.G. dhe Samsung i viktimës A.T..  
-Raporti i Ekzaminim të vendit te ngjarjes nga Njësia i Forenzikes se Krim Tekniques,  
DRP ne  
Peje, NR. TKRP 18/102 se bashku me Fotoalbum i dt.23.09.2018  
Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt. 01.10.2018  
Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt.25.09.2018  
-Vërtetimi mbi konfiskimin i dt.01.10.2018 i një telefoni Samsung dhe kartelës  
045/723-004 „Raport mjekësor për vdekje ne emër te A.T. me nr. 19623 i dt.23.09.2018  
Raport i këqyrjes se vendit te ngjarjes i dt.23.09.2018 TKRP nr 18/102.  
-lista e dëshmime e dt.24.09.2019 -mostrat e marr nga i pandehuri, pistoleta e Llojit  
“Beretta”, predhe e fishekut, gëzhoje me mbishkrim te stampuar SUMBRO  
-Raporti i hetuesit i dt.04.10.2018 -Imer Hylaj 44217  
-Lista e dëshmime e dt.24.09.2018 -Nje IPHONE me nr. -35940608308615-044 998-816  
-prone e Sh.G. Telefon Samsung -045/723-004 i viktimës A.T.  
-Deklarata e dëshmitarit F.Z., e dt.08.10.2018 dhënë ne polici  
-Deklarata e dëshmitarit L.H. e dt.08.10.2018 - dhëne polici  
Raport i ekspertizës balistike-dt. 21.11.2018.me nr. .AKF/-2018-3096/2018-3062  
-Foto dokumentacion —për armën -1eje për arme shenjëtarie —I.C.  
Raport i policit hetues i dt.30.10.2018 -Imer Hylaj  
Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt.18.10.2018 me Foto album  
Raport i ekspertimit balistik i dt.12.11.2018. me nr. AKF/2018-3096-2018-3061  
Raport i ekspertimit balistik i dt.07.11.2018 me nr. -AKF/2018-0322 për mbetjet te  
barotit).  
-Raporti fillestar i incidentit i dt.23.09.2018  
-Flesh raport i dt.23.09.2018 me nr. 2018-DC-339  
-Shënim zyrtar i dt.23.09.2018 me nr. 2018-DC-339 -hetuesi Tahir Mazrekaj, #9172.  
-Raport i policit hetues Imer Hylaj, i dt.08.10.2018 me nr. 2018-HRP-123,  
-shikohet Foto dokumentacioni te cilat gjenden në shkresat e lëndës  
-Lista e foto dokumentacionit dhe lista e dëshmime e dt.23.09.2018, për Pistoletën me  
gaz “Blow TR”, një karikator i pistoletës, një fishek, një çantë për paketimin e armës, te  
konfiskuara nga hetuesi Tahir Mazrekaj,

- leje e veçante e armës –I.C. me nr. DC 142201510515378
- Raporti i policit hetues -Imer Hylaj i dt. 12.10.2018 me -nr 2018-HRP-120
- Raporti i ekspertimit AKF 2018/3096/ 2018-3061 i dt. 12.11.2018
- Raport i ekspertimit i dt.07.11.2018 nga AKF 12018-03/22 i dt 07. 11 .2018
- Analiza e raportit te ekspertizës e dt.24.12.2018 e hetuesit Imer Hylaj
- Raporti i ekspertizës, me nr. 195-FVTI-2018 i (Ët. 19.10.2018. e Sektorit për Fotografi, Video analize dhe Ekzaminime te IT-se
- Lista e dëshmitave e dt.23.09.2018, Një IPHONE nr. karteles 044-998-816 ne emër te Sh.G.t.
- shikohet i CD-2018-DCO-338, 2018 HRP-120 nga Analiza e telefonave
- shikohet Foto Album i Autopsisë dhe lexohet raporti i autopsisë me nr. MA-18203 i mjekësisë ligjore ne emër të A.T. — departamenti i mjekësisë ligjore departamenti ne Prishtinë
- Deklarata e dëshmitares A.C. e dt.08.10.2018 e dhënë ne prokurori
- Deklarata e dëshmitarit N.Gj. e dt.09.10.2018 ne prokurori
- Dëshmitarit A.H., dt. 15.10.2018 , dhe dëshmitarit F.Z., dt. 15.10.2018
- Deklarata e dëshmitares F.M., e dt. 15.10.2018,
- Deklarata e dëshmitarit Zeqe Tishukaj i dt. 17.12 2018,
- Deklarata e dëshmitarit -Dr spec, M.H. i dt.7.12.2018,
- raporti i ekzaminimit psikiatrik nga instituti i Psikiatrisë forenzike i dt.01.03.2019, mbi gjendjen e shëndetit mendor për te pandehurin Sh.G.,
- Përgjigja ne urdhëresën e prokurorisë nga departamenti traseologjisë Forenzike me nr. Reference AKF 2019 - 72 , i dt.11.04.2019, lidhur me veprimet e të pandehurit Sh.G. me armë për ditën kritike.
- Procesverbal mbi marrjen ne pyetje e te pandehurit Sh.G. me dt.04.12.2018, si dhe ajo e dt.02.04.2019.
- Raport i Agjencisë së Forenzikes ne Prishtine i dt. 08.07.2020 me nr. Reference AKF 2020 104 -Procesverbalet mbi intervistën e dëshmitarit P.M. dhe H.D., ne Inspektoratin policor të Kosovës i dt. 18.12.2018, me nr. IPWDH/137/18/VP.
- Deklarata e dëshmitarit H.C., e dhënë ne polici me dt. 16.10.2018 Ref 2018-HRP-120.

Që të gjitha provat të cilat janë proceduar gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar, e po ashtu ka proceduar me prova të tjera. Ka vlerësuar deklaratën e të akuzuarit I.C., i cili ka deklaruar se mbajtja e armës me gaz përmban vepër penale, për të cilën ka kuptuar në polici, dhe ka pranuar se e ka kryer këtë vepër penale, andaj në këtë drejtim nuk ka pasur kontestim nga ana e asnjërës palë. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, ka dëgjuar edhe mbrojtësin e viktimave, i cili ka deklaruar se e përfaqëson palën e dëmtuar, se janë dakortuar, që në këtë çështje penale të ndërmerre të gjitha veprimet e duhura, mirëpo sa i përket kërkesës pasurore juridike, e njëjta duhet të ndërmerret me pëlqimin e palës së dëmtuar.

E dëmtuara A.C., ka deklaruar se nuk është në gjendje të mirë, duke pasur parasysh që fëmijët dhe familja kanë mbetur pa A., por beson që kjo çështje penale do të merr epilog sa më të drejtë.

Nga të gjitha provat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se rikualifikimi i bërë prej veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 në veprën penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK, është bërë i drejtë, sepse edhe nga të gjitha dëshmitë në shkresat e lëndës është vërtetuar se i akuzuari nuk ka pasur qëllim që të kryej këtë vepër penale, dhe si rezultat i së njëjtës, pasi që ka vlerësuar që të gjitha deklaratat, si dhe provat materiale, ka bërë në mënyrë të drejtë dhe të qartë rikualifikimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, për të cilin jemi të mendimit se i njëjti është i drejtë, dhe se i përgjigjet veprës së kryer ditën kritike, sikurse theksohet se me dt.23.09.2018, rreth orës 11:05 minuta, në Deçan, në rr.”Luan Haradinaj”, në kompaninë “Gogaj AG”, nga pakujdesja e privon nga jeta tani të ndjerin A.T., nga fshati Llukë, Komuna e Deçanit, në atë mënyrë që gjersa i akuzuari ishte duke komunikuar në telefon me N.M. – vajzën e hallës, rreth shkuarjes së tij në bjeshkë, dhe duke e porositur që të merr gjësende të tjera ushqimore, posa e përfundon bisedën e lëshon telefonin në tavolinë dhe nga karriga në skajin e majtë të banakut ku ishte ulur, kalon në karrigen tjetër, që gjendet në mes të banakut, lakohet duke shikuar në anën e djathtë kah dritaret, në drejtim të rrugës dhe nxjerr nga sirtari i tret, i anës së djathë revolen e llojit “Bereta mod 92FS”, e vendos në karikator me armë, shkrep në drejtim të A.H., dhe F.Z., të cilët kanë qenë në një distancë prej 70cm, kurse me tani të ndjerin A.T., ka pasur distancë rreth 4-5m, dhe nga kjo shkrepje e godet A.T., në mollëzën e djathë të fytyrës, pastaj e kthen armën ku ka qenë, e që të gjitha këto lëndime të marra kanë qenë shkaktar i vdekjes së të akuzuarit.

Nga përshkrimi i dispozitivit rezulton se gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK, e po ashtu edhe me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, e po ashtu edhe sa i përket të akuzuarit I.C., kemi të bëjmë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, andaj gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtor për këto vepra penale dhe u ka shqiptuar dënimet sipas ligjit.

Prokuroria aktgjykimit e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia dhe e ka gjykuar me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, kurse në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore, i ka shqiptuar dënimin me burgim unik në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashhtë) muaj, mirëpo, konsiderojmë se gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes së rëndë, e jo për veprën penale për të cilën e ka shpallur fajtor.

Sa i përket të akuzuarit të dytë I.C., gjykata e shkallës së parë, e ka shpallë fajtor të akuzuarin për shkak të veprës mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke i shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 2.000

(dymijë) Euro, përkundër asaj që në këtë çështje penale parashihet dënimi me burgim, kurse me dënimin e shqiptuar nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK. Duke i përmbledhur të gjitha çështjet e theksuara, gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, sa i përket të akuzuarit Sh.G., është dashur që të merr si rrethanë lehtësuese vetëm moshën e të akuzuarit, kurse si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, kurse në raport me të akuzuarin I.C., edhe në raport me të njëjtin, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese duke theksuar se i njëjti është familjar, se ka shpreh keqardhje për rastin e ndodhur, kurse si rrethanë rënduese është dashur të ketë parasysh se armën e ka mbajtur pa pasur leje përkatëse, andaj si rezultat i këtyre rrethanave dënimi i shqiptuar me gjobë është i butë dhe me këtë lloj dënimi nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i tij.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penale, është i bindur se nuk ka shkuar sipas rrjedhës së paraparë ligjore, se aktgjykimi përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, që ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në marrjen e vendimit jo të drejtë lidhur me sanksionin penal.

Sa i përket rrethanave lehtësuese gjykata e shkallës së parë, është dashur që ti vlerësojë në masë më të duhur, dhe të akuzuarit ti shqipton një dënim që do të jetë në proporcion me përgjegjësinë penalo juridike, e jo sikurse i ka shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarve, i njëjti ankesën e ka konceptuar edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, mirëpo kolegji nuk e ka shqyrtuar për këto baza ankimore.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, e ka shpallur fajtor të akuzuarin për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, mirëpo përkundër asaj që ka pasur rrethana të bollshme lehtësuese ka dështuar që ti aplikoj të njëjtit për ta zbutur vendimin për dënimin.

Duke filluar nga shpërfillja e pranimit të fajësisë gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se aktgjykimi nuk është i drejtë, sepse pranimi i fajësisë nënkupton fitimin e privilegjeve dhe benefideve, mirëpo i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, mirëpo përkundër asaj që ka pasur rrethana të bollshme lehtësuese, sikurse janë gjendja shpirtërore e të akuzuarit Sh.G., lidhur me ngjarjen tragjike të ndodhur në ditën kritike, se i njëjti është i moshës së re, se ka shpreh gatishmëri që ti

ndihmon familjes së të dëmtuarit, ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese, mirëpo në rastin konkret të njëjtat janë të pa qëndrueshme, andaj duke vlerësuar të gjitha këto rrethana, jemi të bindur se në këtë çështje penale, ka pasur vend hapësirë që të aplikohet instituti i zbutje së dënimit dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, i cili do të jetë në proporcion me peshën dhe përgjegjësinë penalo juridike të akuzuarit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e prokurorisë, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, lidhur me vendimin për sanksionin penal të shqiptuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga vlerësimi i të gjitha provave të proceduara gjatë të gjitha fazave të shqyrtimit gjyqësor, andaj pasi që është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Sh.G., qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK dhe elementet e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ka vlerësuar edhe veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit I.C., kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara në dispozitën ligjore nga neni 73 lidhur me nenin 74 të KPK, ashtu që si rrethanë lehtësuese sa i përket të akuzuarit Sh.G., ka vlerësuar se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare e 4 (katër) muaj e 3 (tri) ditë, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, sikurse si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, e po ashtu edhe ndaj të akuzuarit I.C., si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti është familjar dhe ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, e duke pasur parasysh gjendjen e tij ekonomike, si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit së të njëjtës, i ka shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimimit.

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, përkundër asaj që përqendrohet në bazën ankimore për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, në përmbajtje të së njëjtës, rezulton se përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, e ankimon aktgjykimin edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo kolegji për këto baza ankimore e ka shqyrtuar aktgjykimin më lartë, sikurse sa i përket ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, ka ardhur në përfundim e i njëjti nuk mund të paraqes ankesë për këto baza ankimore, por vetëm për bazën ankimore, sikurse është vendimi lidhur me sanksionin penal, andaj edhe në këtë drejtim për bazën ankimore për të cilën e ka shqyrtuar ka ardhur në përfundim se i njëjti është i drejtë.

Gjithashtu, kolegji ka vlerësuar edhe ankesën e prokurorisë, si dhe përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, nga të cilat nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, e pasi që ka vlerësuar se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal, atëherë ka pasur parasysh se në këtë çështje penale, ankesa e prokurorisë,

lidhur me këtë bazë ankimore e cila është ndërlidhur edhe me shkeljet e tjera sikurse janë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nuk kanë ndikuar në marrjen e një vendimi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, e po ashtu edhe në marrjen e vendimit për dënimin, nga ana e kolegjit të kësaj gjykate.

Kolegji ka vlerësuar ankesat e ushtruara, sikurse është ankesa e prokurorisë, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, e sidomos duke pasur parasysh veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vlerësuar rrethanat e mënyrës së kryerjes së të njëjtës, si dhe duke pasur parasysh praktikën gjyqësore për shqiptimin e dënimit për këtë lloj të veprës penale, e sidomos duke vlerësuar si rrethana lehtësuese, nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, ka vlerësuar se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës 18 (tetëmbëdhjetë) vite, 4 (katër) muaj e 3 (tre) ditë, gjendjen emocionale të shkaktuara pas kryerjes së kësaj veprë penale, ka ardhur në përfundim që të akuzuarit për këtë vepër penale ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, që nënkupton se ky dënim i shqiptuar nga ana e kolegjit është më i butë sesa ai i shqiptuar nga ana e trupit gjykues, në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve.

Andaj, duke i vlerësuar të gjitha ankesat e ushtruara, kolegji i kësaj gjykate ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket vendimit për dënimin, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj, e sidomos duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese, ka aplikuar institutin e zbutjes së dënimit, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë i bindur se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 402 lidhur me 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.422/2024, të datës 03.10.2024**

**Procesmbajtësja,**  
**Njomza Svarça**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Kadrija Goga Lubishtani**

**Valbona Musliu Selimaj**